



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
KËSHILLI DREJTUES

Nr. Prot. 89

Tiranë, 11/09/2020

VENDIM

Nr. 09, datë 11/09/2020

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMI NR. 01, DATË 24.04.2020 “PËR NJË NDRYSHIM
TË RREGULLORES SË PAGAVE NR. 299, DATË 21.11.2016”.**

Në zbatim të Nenit 6, gërma “b” e Ligjit Nr. 10233, datë 11.02.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, i ndryshuar, Rregullores së Pagave nr. 299, datë 21.11.2016, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 62, datë 21.11.2016, me propozim të Drejtorit Ekzekutiv të Autoritetit të Aviacionit Civil, Këshilli Drejtues,

VENDOSI

1. Pika 2 e Vendimit të Këshillit Drejtues Nr. 62, datë 21.11.2016, saktësohet si më poshtë vijon: “Paga bazë, në vlerë absolute duke filluar nga viti 2017, e Drejtorit Ekzekutiv të jetë në shumën 240,000 lekë”.
2. Paga bazë për të gjitha kategoritë e tjera ndryshon sipas përcaktimeve të Lidhjes II të Rregullores së Pagave.
3. Vendimi Nr. 01, datë 24.04.2020 “Për një ndryshim të Rregullores së Pagave Nr. 299, datë 21.11.2016, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr. 62, datë 21.11.2016”, shfuqizohet.
4. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më datë 1 Shtator 2020.
5. Efektet financiare të reflektohen në Programin Ekonomik të vitit 2020.

6. Ngarkohet Drejtori Ekzekutiv për zbatimin e këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Ministri.

KRYETARI I KËSHILLIT DREJTUES
Dritan Gjonbalaj